




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj



Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2. , neni 14 paragrafi 5, neni 15 dhe neni 16 I Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 13, nenin 14 dhe 15 të Rregullores (QRK) 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës, Vendimit paraprak (për dhënien e pronës së paluajtshme Komunale në shfrytëzim afatgjatë deri 99 vite, personit fizik/juridik) të Kuvendit Komunal të Skenderajt nr. 01-463/01-0060450/23 të dt. 01.12.2023, dokumenteve të Planifikimit Hapësinor të Komunës së Skenderajt Hartës Zonale 2020-2028 dhe Planit Zhvillimor Komunal, nenit 5 shkronja b), dhe nenit 14 t Ligjit pr Vetqeverisje Lokale nr. 03/L-040, në përputhje të plotë me procedurat administrative që rrjedhin nga Ligji për Proceduren e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 Komisioni i emëruar me vendim të Kuvendit nr. 01-020/01-0060455/23 I dt. 01.12.2023, me kompetenca të plota me datë 18.07.2024 shpall këtë ;

NJOFTIM PUBLIK
për Shprehje të Interesit

1. Komuna e Skenderajt/Komisioni nr. 01-020/01-0060455/23 përmes kësaj shpallje njofton të gjithë personat fizik/juridik që janë të interesuar dhe shprehin interes të aplikojnë për:

Marrjen në shfrytëzim afatgjatë nëntë dhjetë e nëntë (99) vite, përmes kësaj procedure të hapur konkurruese për shprehje interesi , për pronën e paluajtshme në pronësi të Komunës me të dhënat si vijon:

- **Parcela kadastrale Nr. 699-2, në pronësi të Komunës me sipërfaqe 3000m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 11232m² , lloji i shfrytëzimit tokë ndërtimore, zona Kadastrale Skenderaj.**

2. Veprimtaria që do të ushtrohet përmes dhënies në shfrytëzim afatë gjatë të pronës së lartë cekur sipas qëllimit dhe destinimit të pronës si dhe në përputhje të plotë me dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës së Skenderajt është:

- **Ndërtimi I objektit afarist banesor P+7 me ISN 3.0, ZSHP- QB , me qëllim të përfitimit ekonomik-financiar të Komunës së Skenderajt përmes llogaritjes së përqindjes së sipërfaqes ndërtimore të ofruar nga ofertuesit përmes ofertave të mbyllura.**

3. Aplikimi bëhet përmes dorëzimit të ofertave të mbyllura nga ofertuesit (persona fizik/juridik) në shprehjen e interesit për marrjen në shfrytëzim të pronës publike të lartë cekur permes konkurrimit të hapur, me ç'rast do të përzgjedhet oferta ekonomikisht ma e favorshme duke përfshirë këto kritere:



- **Vlerën e investimit**
- **Numërin e të punësuarve nga investimi,**
- **Llojin e investimit sipas veprimtarisë së cekur më lartë**
- **Përfitimën financiar dhe ekonomik të Komunës sipas ofrimit të përqindjes së sipërf. së ndërtimit**
- **Ndikimin e rritjes të vlerës së pronës**
- **Dhe çdo ofrim/kriter i ofruar me shumë nga të cekurat më lartë që ndikon në rritjen financiare dhe ekonomike të ofertës.**

4. Të drejtën e aplikimit e kanë të gjithë personat fizik/juridik që janë të evidentuar dhe regjistruar në Republikën e Kosovës, ku me të drejtën e aplikimit ju njihen edhe këto të drejta:

- **Të informohen me procedurat e shprehjes së interesit,**
- **Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim**
- **Të kenë qasje në dokumentacionin e pronës së dhënë në shfrytëzim**
- **Të tërhiqen nga konkurrimi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.**

5. Afati për aplikim është pesëmbëdhjetë (15) dite kalendarike nga dita e publikimit të kësaj shpallje, dhe dita e fundit për aplikim do të jetë data 01.08.2024 (ditë e enjete).

6. Ofertat do të dorëzohen në zarf të mbyllur tek Qendra për Shërbime me Qytetar kati përdhësë, objekti i Komunës së Skenderajt, ku do marrin nr. protokoli dhe do vazhdojnë të ruhen në mënyrën e mbyllur si janë dorëzuar në Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, me ç'rast do të happen në prani të të gjithë ofertuesve dhe komisionit për zhvillim të procedurave me datë: 05.08.2024 (ditë e hëne).

7. Cmimi për pjesmarrje në këtë procedure konkurrimi përmes shprehjes së Interesit si depozit do të jetë 50.000,00euro (pesëdhjetëmijë euro).

8. Për ç'do informacion shtesë nga ofertuesit si pike kontaktuese do të jetë zyrtari ligjor në DGJKP, me nr. tel. +38348777722.

**Komisioni me nr. të Vendimit 01-020/01-0060455/23
në përbërje:**

1. znj. Blerta Dobra- Geci nga ekzek. kryesuese,
2. z. Ismet Aliu nga ekzekutivi –anëtar,
3. z. Avdullah Geci nga Kuvendi- anëtar,
4. z. Dardan Shala nga Kuvendi- anëtar,
5. z. Milazim Mustafaj shqerri civile –anëtar,



Skenderaj, me datë: 18.07.2024